



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.923/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 neni 5 paragrafi (d), Udhëzimi Administrativ Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo – Arsimorë dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit , Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25. 02. 2021 merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës për pozitën drejtor /esh për një (1) pozitë në Institucionit Parashkollorë (IP) dhe një (1) pozitë drejtor /esh në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Ilaz Thaçi” Hani i Elezit.
2. Duke iu referuar nenit (1) të këtij vendimi, komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - Sear Dernjani, (nga DKA) kryesues i komisionit,
 - Vlora Suma, (nga këshilli i prindërve), anëtare dhe
 - Një (1) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës-anëtarë.
3. Komisioni përzgjedhës do të veproj në bazë Udhëzimi Administrativ Nr.151/2020 MASHT.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komisionit
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2021





01/Nr. 955/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2021 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve të mjeteve buxhetore për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa.
3. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë për vitin 2020 është në lartësi prej 2,742,094.82 €, ndërsa ai përfundimtar është 3,277,468.59 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-dhjetor 2020 është në shumë prej 3,087,211.70 € apo 94.20 %. Prej tyre për Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,577,266.70 € apo 99.53 %, mallra dhe shërbime 382,355.03 € apo 87.62 %, shpenzime komunale 61,959.21 € apo 99.93 %, subvencione dhe transfere 155,945.50 € apo 96.72 % dhe shpenzime kapitale 909,685.26 € apo 88.05 %.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2021



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 956 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 07/L-041 për vitin 2021 neni 9, paragrafi 6, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 25.02.2021 merr këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE NGA VITI 2020 NË VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2020 në vitin 2021.
2. Të hyrat e bartura nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë në shumën prej 85,891.91 €, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 84,716.27 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 1,175.64 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2020 kanë qenë në shumë prej 244,099.82 €, prej tyre janë të shpenzuara 187,495.58 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 56,604.24 €. Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2019 dhe 2020 janë në shumën prej 57,779.88 €, të cilat i bartim për vitin 2021.
3. Këto mjete sipas pikës 2 (në shumë prej 57,779.88 €), i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:
 - mallra dhe shërbime në shumë prej 7,079.61 €,
 - subvencione dhe transfere në shumë prej 5,290.00 € dhe
 - shpenzime kapitale në shumë prej 45,410.27 €.
4. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej 7,079.61 €, në nën-programet si vijon:
 - Administrata (16335), kodi funksional (0133), shuma prej 2,523.00 €,
 - Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 2,444.00 €,
 - Administrata e arsimit (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 1,822.61 €,
 - Arsimi i mesëm (95220), kodi funksional (0922), shuma prej 290.00 €.
5. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej 5,290.00 €, në nën-programin, si vijon:
 - Zyra e kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej 5,290.00 €.

6. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej 45,410.27 € në nën-programet dhe në projektet, si vijon:

Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve (18444), në projektin:

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”, kodi (47216) shuma prej 28,000.00 €.

Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), në projektet:

“Mjete të lira për bashkëinvestime”, kodi (41641) shuma prej 9,247.27 €,

“Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në zonat urbane dhe rurale (49987) shuma prej 3,227.10€.

Shërbimet e shëndetësisë primare (75050), në projektin:

“Renovimi i objektit të QKMF-së”, kodi (49993) shuma prej 4,935.90 €.

7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data : 25.02.2021



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1170/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 pika o), Statutin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.7703/2018 neni 11 pika r) dhe në bazë të kërkesës 01/Nr.1078/2021, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25. 02. 2021 merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PARKUT "HASAN PRISHTINA" NË QENDRËN PËRKUJTIMORE "BLLACA 99"

1. Miratohet kërkesa me numër 01/Nr.1078/2021 e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH) –Shkup, përfaqësuar nga Skender Hasani, Mehmet Prishtina dhe Jahja Lluka.
2. Parku i Qendrës Përkujtimore për Gjenocidin mbi Shqiptarët "BLLACA 99" emërohet me emrin "HASAN PRISHTINA" zona Kadastrale Hani i Elezit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse të komunës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 968/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2021 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 969/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit numër 01/Nr.9274/2019, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25. 02. 2021 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS
SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Administratës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2021

